



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2967/6 prot.

Datë 17.11.2025

V E N D I M

Nr. 1691/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.11.2025 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik, “CLASS ASHENSOR” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-55989-07-23-2025, me objekt: “Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve”, me fond limit 4,783,050.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 03-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
Adresa. Bulevardi Gjergj Fishta, Tirana.

Ankimues:

Operatori ekonomik “CLASS ASHENSOR” SHPK me NIPT L01325010Q dhe adresë: Rruga Hasan Vogli, Zona Kadastrale 3292, Nr. Pasurie 68/68-d2, Selitë, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.162/2020 *“Për prokurimin publik”*.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.07.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-55989-07-23-2025, me objekt: “Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve”, me fond limit 4,783,050.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 03-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

II.2. Në datën 03-10-2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 06-10-2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “CLASS ASHENSOR” SHPK 3,928,680.00 Skualifikuar (*Operatori ekonomik duhet te provoje qe cdo pjese furnizim vendosje (referuar preventivit te sherbimeve shtojca 7 e DT) duhet te ketë origjine nga prodhuesi ne perputhje me specifikimet teknike te ashensoreve qe parashikohet te mirembahen sipas Shtojces 5 te DT. Kjo e vertetuar me autorizim mbeshitetje me pjese kembimi, leshuar nga prodhuesi / distributori i autorizuar ne emer te operatorit ekonomik pjesemarres. * ne dokumentat e ofertes nuk rezulton e provuar permbushja e ketij kriteri, nuk arrin te deshmoje qe cdo pjese e kerkuar ka origjine nga prodhuesi, kjo ne perputhje dhe me specifikimet teknike.*)

2. “VERTIKUS” SHPK 4,427,700.00 Kualifikuar

II.4 Në datën 15.10.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 21.10.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5987 dhe nr.2967 prot., datë 22.10.2025 e operatorit ekonomik “CLASS ASHENSOR” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-55989-07- 23-2025, me objekt: “Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve”, me fond limit 4,783,050.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 03-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “CLASS ASHENSOR” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën

e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2967/1 prot, datë 23.10.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “CLASS ASHENSOR” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 9821/3 prot., datë 30.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2967/2 prot., datë 03.11.2025, ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “CLASS ASHENSOR” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Nëpërmjet sistemit elektronik është depozituar po e njëjta shkresë me të njëjtën përmbajtje nga autoriteti kontraktor protokolluar me tonën me nr.2967/3 datë 10.11.2025, prej ku rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “CLASS ASHENSOR” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “CLASS ASHENSOR” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre, me arsyen se : *“Në fakt, në dokumentacionin e ofertës sonë është dorëzuar deklaratë zyrtare, Autorizim Prodhuesi Certifikatat CE te prodhuesit, Autorizim nga prodhuesi te bashkangjitur dhe listen e pjesëve, Vertetime realizimi pune te ngjashme dhe identike, etj Sipas Shtojcës 6 (Formularit të Specifikimeve Teknike), tek Dokumentat e Tenderit (D.T.) në vetë përmbajtjen e tij të publikuar nga A.K. në S.P.E. e A.P.P. theksohet se në specifikimet teknike nuk lejohet të përmendet ndonjë markë, prodhues apo origjinë specifike, për të mos favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar. Përgjashtimisht, kjo lejohet vetëm kur është e domosdoshme dhe duhet të shoqërohet me shprehjen “ose ekuivalent.... Në këtë aspekt Operatori Ekonomik CLASS Ashensor deklaroi se:- Ka autorizim nga prodhuesit Ah-Met dhe DelFar, për furnizim me Ashensore dhe pjesë këmbimi për ashensorë te ndryshem . - Disponon fatura blerje origjinale për pjesë këmbimi nga dhjetëra prodhues dhe furnitorë të ndryshëm, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë komponentësh për ashensorë të ndryshëm, përfshirë edhe ato të markave të njohura si KONE, Otis, Schindler, Sicor, Alberto Sassi, Akar, Moris, Fermator, Merih, Eker, Genemek, Monarch, TorinDrive, Biofial, Mikrolift, etj. Këto dokumente dhe marrëveshje provojnë se OE*

“Class Ashensor” Sh.p.k. ka akses real dhe të ligjshëm në tregun e pjesëve të këmbimit, duke përbushur një nga kriteret thelbësore teknike për mirëmbajtjen dhe riparimin e ashensorëve, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Referuar këtyre standarteve ju bëjmë me dije se kompania jone është e çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të mëposhtme:- ISO 9001 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë - ISO 45001 – Shëndeti dhe Siguria në Punë - ISO 27001 – Siguria e Informacionit - ISO 14001 – Menaxhimi Mjedisor .Këto çertifikata dëshmojnë angazhimin tonë për ofrim të shërbimeve të standardizuara, të sigurta dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi. ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 9 *“Formular I Krieteve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit”*, e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.3. Operatori ekonomik duhet te provoje qe cdo pjesë furnizim vendosje (referuar preventivit te shërbimeve shtojca 7 e DT) duhet të ketë origjine nga prodhuesi ne perputhje me specifikimet teknike te ashensoreve qe parashikohet te mirembahen sipas Shtojces 5 te DT. Kjo e vertetuar me autorizim mbeshtetje me pjese kembimi, leshuar nga prodhuesi / distributori i autorizuar ne emer te operatorit ekonomik pjesemarres.”

-Ndërsa në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit *“Formular I Shërbimeve Dhe Grafikut Të Ekzekutimit”*, e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

12	Materiale per mirembajtjen e ashensoreve	F.V. Graso ne nyjet levizese	Kg	10	30
13		F.V. Llampa 100 Ë per ndricimin e pusit	cope	14	42
14		F.V. Celsa te dyerve te kateve	cope	24	72
15		F.V. Celsa avarie te kabines	cope	8	24
16		F.V. Butona te thirrjes se kateve	cope	24	72
17		F.V. Rripa transmisioni te dyerve	cope	40	120
18		F.V. Llampa kabine per ndricim	cope	12	36
19		F.V. Sensore magnetik	cope	12	36
20		F.V. Automat termo/el.manj. Diferecial 2P, 220	cope	8	24
21		F.V. Automat magneto-termik 380 V, 25A, 4P,	cope	8	24
22		F.V. Butona tregues te dyerve te jashtme	cope	8	24
23		F.V. Butoneri e brendeshme	cope	8	24
24		F.V. Kabell fleksibel ashensori	MI	18	54
25		F.V. Kavo celiku fi 12 ashensorët	MI	300	900

26	F.V. Patina portash	cope	24	72
27	F.V. Rula per hapje dhe mbyllje dere	cope	24	72
28	F.V. Ferrota per frenat e motorrit	cope	20	60
29	F.V. Inverter dyersh	cope	4	12
30	F.V. Pult komandimi	cope	4	12
31	F.V. Leshues 63A	cope	4	12
32	F.V. Operator kabine	cope	4	12
33	F.V. Kuader manovre (panel komandimi)	cope	4	12
34	F.V. Panel ashensori VVVF (Paneli elektrik 15 kË)	cope	4	12
35	F.V. Motor mekanik kabine (24V D.C)	cope	4	12
36	F.V. Fotocelule (12 V DC)	cope	6	18
37	F.V. Akses karte	cope	12	36
38	F.V. Kontaktet e dyerve te jashteme	cope	12	36
39	F.V. Display	cope	6	18

III.1.2. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket kriterit 2.3.3, operatori ekonomik “Class Ashensor” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:



Autorizim_nga_Prodhuesi.pdf

- “CERTIFKATE AUTORIZIMI

Ne AH&MET ASANSOR SAN, VE TIC, LTDOSTIo (Address: 3.Organize Sanayi T.Ziyaeddin Akbulut Cad. no: 16 Selguklu / KONYA / TURKEY) i sigurojm produktet dhe prodhimin tone CLASS ASHENSOR Sh.p.k ne territorin e Shqiperise sipas tabelës meposhtme.

We hereby certify that, AH&MET ASANSOR SANO VE TIC, LTD.STI. (Address: 3.Organize Sanayi T.Ziyaeddin Akbulut Cad. no: 16 Selguklu / KONYA/ TURKEY) provides it's oën manufactured products to CLASS ASHENSORShpk in ALBANIA territory according table beloë.

12	F.V. Graso ne nyjet levizese	Grease	Kg	30
13	F.V. Lampa 100 W per ndricimin e pusit	Shaft Light 1201m 100 W Led Panel	cope	42
14	F.V. Celsa te dyerve te kateve	Door Lock Mechanism	cope	72
15	F.V. Celsa avarie te kabines	Car Cabin Door Lock Mechanism	cope	24
16	F.V. Butona te thirrjes se kateve	Floor Push Button. (Lop Button)	cope	72
17	F.V. Rripa transmisioni te dyerve	Car Cabin Door Drive Belt	cope	120
18	F.V. Lampa kabine per ndricim	Car Cabin Lights	cope	36
19	F.V. Sensore magnetik	Monostable Magnetic Switch	cope	36
20	F.V. Automat termo/el.manj. Diferecial 2P, 220	Earth Leakage Circuit Breaker 2P, 220 V	cope	24
21	F.V. Automat magneto-termik 380 V, 25A, 4P,	Circuit Breaker 380 V, 25A, 4P	cope	24
22	F.V. Butona tregues te dyerve te jashtme	Floor Push Button. (Lop Button)	cope	24
23	F.V. Butoneri e brendeshme	Car Push Button	cope	24
24	F.V. Kabell fleksibel ashensori	flexible cable for elevator	MI	54
25	F.V. Kavo celiku fi 12 ashensoret	Rope 12 mm	MI	900
26	F.V. Patina portash	Doors paten	cope	72
27	F.V. Rula per hapje dhe mbyllje dere	Door Roller	cope	72
28	F.V. Ferrota per frenat e motorrit	Machine Brake	cope	60
29	F.V. Inverter dyersh	Door Control Board	cope	12
30	F.V. Pult komandimi	Revizjon control	cope	12
31	F.V. Leshues 63A	Contactors 63 A	cope	12
32	F.V. Operator kabine	CABIN OPERATOR	cope	12
33	F.V. Kuader manovre (panel komandimi)	CONTROL PANEL	cope	12
34	F.V. Panel ashensori vvvf (Paneli elektrik 15 kW)	VVVF elevator panel (15kW electrical panel)	cope	12
35	F.V. Motor mekanik kabine (24V DC)	Cabin door motor (24V DC)	cope	12
36	F.V. Fotocelule (12 V DC)	Door Detector (12 vdc)	cope	18
37	F.V. Akses karte	Access controller	cope	36
38	F.V. Kontaktet e dyerve te jashteme	Landing Door Lock Mechanism	cope	36
39	F.V. Display	Display	cope	18

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin

informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”

III.1.6. Në Nenin 92 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin

publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuesë dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuesë dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurim.

III.1.8. Në këtë rast, referuar dhe sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar në pikën 2.3.3 kapaciteti teknik, dokumentet që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Class Ashensor” SHPK në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pika 2.3.3 kapaciteti teknik KPP konstaton, se ky i fundit, ka dorëzuar dokumentacionin me titullin “Autorizim_nga_Prodhuesi” në përmbajtje të të cilit konstatohet autorizimi i kërkuar në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues, si pjesë të ofertës së tij, ka dorëzuar dokumentacionin sipas formës së kërkuar në dokumentet standarde të tenderit për kriterin e mësipërm prej nga ku konstatohet se operatori ekonomik konkretisht ka dorëzuar sic dhe cituar në pikën III.1.2 të këtij vendimi autorizimin e lëshuar nga shoqëria “*AH&MET ASANSOR SANO VE TIC, LTD.STI.*” e cila është dhe prodhuese e materialeve të kërkuara për mirëmbajtjen e ashensorëve nga autoriteti kontraktor sipas shtojcës 7 të dokumentave të tenderit, për shoqërin “*CLASS ASHENSOR*” Sh.p.k. Komisioni sjell në vëmendje se janë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, që me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe kriteret teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Nga sa parashtuar dhe më sipër si dhe nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Class Ashensor” SHPK se *nuk arrin të dëshmojë që cdo pjesë e kërkuar ka origjinë nga prodhuesi, kjo në përputhje dhe me specifikimet teknike*, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues “Class Ashensor” SHPK ka plotësuar kriterin 2.3.3 të dokumentave të tenderit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, është i plotësuar nga operatori ekonomik “Class Ashensor” SHPK, e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Class Ashensor” Shpk për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-55989-07-23-2025, me objekt: “Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve”, me fond limit 4,783,050.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 03-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi, për operatorin ekonomik “Class Ashensor” Shpk.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Class Ashensor” Shpk.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

